



VENDIM

Nr. 70 Datë 09.08.2011

**PËR
FILLIMIN E PROÇEDURAVE TË LICENSIMIT TË SHOQËRISË
“DITEKO” SH.P.K NË AKTIVITETIN E TREGËTIMIT T ENERJISË
ELEKTRIKE**

Në mbështetje të nenit 8 pika 2 gërma “a”, nenit 9 dhe 13 pikat 1, gërma “d”, të Ligjit Nr. 9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar, neneve 4 pika 1 gërma “g” dhe 10 pikat 1, dhe 3 të “Rregullores për procedurat e liçensimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të liçensave”, të miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve Nr.108 datë 09.09.2008, dhe nenit 18, pikat 1, gërma “a”, të “Rregullave të Praktikës dhe Proçedurave të ERE-s”, miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerve, Nr.21, datë 18.03.2009, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 09.08.2011, mbasi shqyrtoi kërkesën e shoqërisë “DITEKO” sh.p.k, si dhe relacionin e Drejtorisë së Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit mbi liçensimin në aktivitetin e tregëtimit të energjisë,

Konstatohet se :

Aplikimi i shoqërisë “DITEKO” sh.p.k plotëson kërkesat e parashikura nga ERE në Rregulloren për procedurat e liçensimit, modifikimit, transferimit të plotë /të pjesshem dhe rinovimit të liçensave si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni finaciari dhe fiskal (neni 9, pika 3) janë paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni teknik (neni 9, pika 4.10) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër cituar Bordi i Komisionerëve të ERE-s,

Vendosi:

1. Fillimin e procedurave për shqyrtimin e aplikimit për licensë të shoqërisë “DITEKO” sh.p.k në aktivitetin e Tregëtimit të Energjisë Elektrike.
2. Drejtorja e Licensimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojnë aplikuesin për Vendimin e Bordit të Komisionereve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjehere.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol RAMADANI